REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i arsimit,rinisë,sporteve e trashëgimisë kulturore

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.33, datë 30.04.2026, me titull"Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.121 datë 31.08.2023 'Ngritjen e këshillit artistiko-kulturor dhe miratimin e rregullores së funksionimit dhe financimit të projekteve pranë Bashkisë Sarandë'".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; Ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", neni 28; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 21.12.1992 "Për krijimin e këshillave artistiko-kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre"; dhe Udhëzimin nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturor".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti synon ndryshimin e pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 121, datë 31.08.2023, i cili ka ngritur Këshillin Artistiko-Kulturor pranë Bashkisë Sarandë. Ky këshill përbën një organ këshillimor me rol në mbështetjen, vlerësimin dhe promovimin e veprimtarive artistike dhe kulturore në territorin e bashkisë.

Arsyeja e ndryshimit është se mandati i anëtarëve të përbërjes fillestare të Këshillit Artistiko-Kulturor ka përfunduar, duke krijuar nevojën për rikonfigurimin e përbërjes së këtij organi. Ndryshimi i propozuar synon të garantojë vazhdimësinë institucionale të këshillit dhe të përditësojë përbërjen e tij në përputhje me nevojat aktuale të zhvillimit kulturor të Bashkisë Sarandë.

Ndryshimi i përbërjes nuk prek parimet, rregullat dhe procedurat e funksionimit të këshillit, të cilat mbeten të pandryshuara sipas rregullores së miratuar më parë.

Objektivat e punës së Këshillit Artistiko-Kulturor përfshijnë:

· Vlerësimin e cilësisë artistike të projekteve të paraqitura nga subjekte të ndryshme.

· Vlerësimin e projekteve që synojnë veprimtari elitare dhe pjesëmarrje aktive nga publiku i gjerë.
· Vlerësimin e aktiviteteve tradicionale në kalendarin kulturor, rinor dhe sportiv të qytetit.
· Vlerësimin e aktiviteteve që synojnë njohjen dhe futjen në axhendën kombëtare dhe ndërkombëtare të kulturës, artit dhe sportit shqiptar.
· Dhënien e mendimeve dhe propozimeve për mbështetjen e talenteve të reja në kuadër të politikave kulturore.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Projektvendimi nuk sjell efekte financiare të drejtpërdrejta për buxhetin e Bashkisë, përveç të drejtave të mundshme për anëtarët e këshillit në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM nr. 540/1992). Çdo aktivitet financiar do të kryhet brenda fondeve të miratuara të Qendrës Kulturore.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Qendra Kulturore,Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës .

Impakti social / grupet që preken:
· Artistët, krijuesit kulturorë dhe subjektet që aplikojnë për mbështetje financiare për projekte në fushën e artit dhe kulturës.
· Publiku i gjerë i Sarandës, përmes një politike kulturore më cilësore, transparente dhe të mbështetur në ekspertizë profesionale.
· Talentet e reja në fushën e artit dhe kulturës, të cilat do të marrin mbështetje më të mirë institucionale.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i arsimit,rinisë,sporteve e trashëgimisë kulturore,
I propozon Këshillit Bashkiak: projektvendimin Nr.33,datë 30.04.2026,me titull"Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.121 datë 31.08.2023 'Ngritjen e këshillit artistiko-kulturor dhe miratimin e rregullores së funksionimit dhe financimit të projekteve pranë Bashkisë Sarandë'".

Ermir Hoxha **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Zana Piro **Sekretare e Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.28, datë 30.04.2026, me titull "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2026".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 3 datë 29.01.2026 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr. 153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)
Projekti synon shpërndarjen e ndihmës ekonomike për muajin mars 2026, nga të ardhurat e bashkisë, për 53 familje në total, me një fond prej 219,017 lekë. Shpërndarja bëhet si më poshtë:

· Për Qendrën e Bashkisë Sarandë: 41 familje me 152,687 lekë.
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 12 familje me 66,330 lekë.

Projekti përcakton edhe përjashtimin e disa familjeve nga skema, pasi ato tashmë përfitojnë nga skema 6% e bllok-ndihmës .Njëkohësisht: 7 familje të reja hyjnë në skemë – të gjitha me kryefamiljare gra pensioniste me të ardhura të pamjaftueshme dhe probleme të rënda shëndetësore , 1 familje tjetër trajtohet për herë të parë, me kryefamiljare grua me probleme të rënda shëndetësore dhe në pamundësi lëvizjeje.

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)
Shuma totale prej 219,017 lekë parashikohet të shpenzohet nga të ardhurat e bashkisë, në përputhje me buxhetin e miratuar për vitin 2026 dhe kriteret për ndihmën ekonomike.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social do të monitorojë shpërndarjen e subvencionimeve dhe do të raportojë.

Impakti social / grupet që preken:
53 familje në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, duke përfshirë gra kryefamiljare pensioniste me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe familje me probleme të rënda shëndetësore.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim
Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale i propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit projektvendimit Nr.28, datë 30.04.2026, me titull "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin mars 2026".

Laureta Ceci — **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjeza Dike — **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË
SARANDË

Komisioni i Barazisë gjinore dhe Mirëqënies Sociale

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Sarandë

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projektvendimit Nr.27,date 30.04.2026, me titull "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin mars 2026".

Analiza ligjore:

Duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", nenet 9 dhe 24; Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 617 datë 22.09.2022; Udhëzimin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind"; dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr. 3 datë 29.01.2026 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti synon përdorimin e fondeve të kushtëzuara për ndihmë ekonomike mujore deri në 6% të buxhetit vendor, për muajin mars 2026. Një total prej 20 familjeve do të përfitojnë një ndihmë totale prej 80,395 lekë, e shpërndarë si më poshtë:
· Për Bashkinë Sarandë: 19 familje me një fond total prej 74,514 lekë (sipas listës nr. 1).
· Për Njësinë Administrative Ksamil: 1 familje me një fond prej 5,881 lekë (sipas listës nr. 2).

Përzgjedhja e familjeve është bërë në bazë të kritereve të miratuara me VKB Nr. 3 datë 29.01.2026, duke përfshirë:
· Kryefamiljare gra (pensioniste, në prag pensioni, me të ardhura të pamjaftueshme)
· Familje me probleme të thella sociale
· Familje me fëmijë me probleme të rënda shëndetësore

Situata financiare: (Shtesa / pakësime në buxhet)

Shpenzimet parashikohen në kuadër të fondit të kushtëzuar për ndihmë ekonomike, brenda kufirit të 6% të buxhetit vendor për vitin 2026. Shuma totale prej 80,395 lekë do të shpërndahet në bazë të listave të miratuara.

Drejtoria / Sektori përgjegjës A

Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Sarandë.

Monitorimi dhe raportimi:

Drejtoria e Kujdesit Social, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, do të monitorojë shpërndarjen e fondeve dhe do të raportojë për përdorimin e tyre në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Impakti social / grupet që preken:

20 familje në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale në Bashkinë Sarandë dhe Njësinë Administrative Ksamil, me fokus të veçantë te gratë kryefamiljare, pensionistet, dhe familjet me fëmijë me probleme të rënda shëndetësore.

A është objekt i konsultimit publik?

Jo.

Vendosim

Duke marrë parasysh analizën e mësipërme, Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale I propozon Këshillit Bashkiak: Miratimin e projekt-vendimit Nr.27, datë 30.04.2026, me titull "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin mars 2026".

Laureta Ceci **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Anjeza Dike **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)